



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

E.Rev.nr.7/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Milena Gjeriq, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - përbarimore të kreditorit: N.SH., "...", me seli në F., me pronar E. Sh., N. Sh. dhe I. Sh., të cilët i përfaqëson N. A., avokate në L., sipas autorizimit, kundër debitorit: Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.p.k., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson L. S., sipas autorizimit, për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me revizionin e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr. 745/22, të datës 14.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 11.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË i palejuar revizioni i kreditorit: N.SH., "...", me seli në F., me pronar E. Sh., N. Sh. dhe I. Sh., i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr. 745/22, të datës 14.04.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.1245/20, të datës 03.12.2020, ka vendosur: I. Aprovohet prapësimi i debitorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.p.k., me seli në Prishtinë, shfuqizohet urdhri përbarimor, P.nr..., i datës..., i lejuar nga Z. P. e P. P., I. I., në P., si dhe anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra nga përbaruesi privat. II. Lirohet garancioni dhe urdhërohet shërbimi i arkës së kësaj gjykate, që t'ia kthejë mjetet monetare në shumën prej ... €, të deponuara më datë ... nga debitori i përbarimit, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.p.k., me seli në Prishtinë, në formë të garancisë dhe në llogarinë përkatëse të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe t'ia kthejë debitorit, në xhirollogarinë bankare të debitorit, pasi që ky aktvendim të bëhet i formës së prerë.

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr. 745/22, të datës 14.04.2023, është vendosur që të: Refuzohet si e pabazuar ankesa e kreditorit

N.SH., "...", me seli në F., me pronar E. Sh., N. Sh. dhe I. Sh., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.1245/20, i datës 03.12.2020, vërtetohet.

Kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë, ka paraqitur revizion kreditori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së dytë DH.SH.II.nr.745/22 i datës 14.04.2023 si dhe aktvendimit PPP.nr.1245/20, i datës 03.12.2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm të prishen dhe i njëjti të ndryshohet.

Përgjigje në revizion nuk ka pasur.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe nenit 68 paragrafi1 të Ligjit nr. 04/L-139, për Procedurën Përmbartimore, ka gjetur se:

Revizioni i kreditorit është i palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Z. P. e P.P. I. I., në Prishtinë, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës me numër..., të datës..., në vlerë prej ... €.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit, në afatin ligjor, prapësim ka paraqitur debitori.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, ka nxjerr aktvendimin PPP.nr.1245/20, të datës 03.12.2020, me të cilin e ka aprovuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, kreditori ka paraqitur ankesë, ndërsa Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 745/22, të datës 14.04.2023, ka vendosur që të refuzojë ankesën e kreditorit si të pabazuar, ndërsa aktvendimin e shkallës së parë ta vërtetojë, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, debitori ka paraqitur revizion, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë çështje juridike - përmbartimore fillimisht vlerësoi lejueshmërinë e revizionit dhe konstatoi se në këtë rast revizioni është i palejueshëm, për arsye se:

Me nenin 218, të LPK-së, dhe nenin 11, të Ligjit Nr. 04/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, me të cilin është riformuluar neni 218 i ligjit bazik, përcaktohet se: " 1. Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm apo jo i plotë, hudhet poshtë me aktvendim të Gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore. 2. Revizioni është i palejueshëm nëse: a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit; b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin; c) nëse personi i cili

ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij; d) është paraqitur revizioni kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet ”.

Me nenin 68 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/l-139, për Procedurën Përmbaremore, përcaktohet se: “ Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbaremore ”, dhe duke marrë parasysh faktin se revizioni është paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr. 745/22, të datës 14.04.2023, i cili vendim është marrë në procedurën e përmbaremit, revizioni është i palejuar, për çka revizioni i kreditorit është dashur të hedhet poshtë.

Andaj më qenë se gjykata e shkallë së parë nuk e ka hedh revizionin e kreditorit ashtu siç përcaktohet me nenin 218 të LPK-së, atëherë Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 221 të LPK-së, vendosi që ta hedhë poshtë si të palejueshëm revizionin.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim nenin 68 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/l-139, për Procedurën Përmbaremore, nenit 221, e lidhur me nenin 230 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
E.Rev.nr. 7/24, më datë 11.03.2024

Kryetari i kolegjit
Rrustem Thaqi